

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Abilekaj: Gabuam duke i parë serbët si partnerë, vendimi Hagës na gjeti të gjithëve në faj - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/abilekaj-gabuam-duke-i-pare-serbet-si-partnere-vendimi-hages-na-gjet-i-te-gjitheve-ne-faj/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 20:01:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 19:58:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a62f2080cc219bfefb21e1402af4bb24ec91d78c3ccdf9aa0071c9af905e38a98
TEKSTI	bc4db6e64ceac32b1d867e137f5bebad197ca7bfe8a15d3f6bd1ef1757e1a11b
PAMJA	b17d18a0ea35d79158f525ce692ae561187b6fe89f00f88397cdc55f15a9347b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5c075595a7f8d4c51b5d0447507106cd0fd03376b060976993976cc797f3c478
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b36d3d1202e685b83ffc611c8f22a5defe9644c370970134944b31e37e025b7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5c075595a7f8d4c51b5d0447507106cd0fd03376b060976993976cc797f3c478>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Bedri Hamza SHBA Turqi enton abilekaj

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT

Abilekaj: Gabuam duke i parë serbët si partnerë, vendimi Hagës na gjeti të gjithëve në faj



17 Shtator 2026 | 21:58

I ftuar në "Now me Erla Mëhillin", gazetari Enton Abilekaj komentoi vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë për katër ish-drejtesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Abilekaj tha se situata aktuale është rezultat i një ndryshimi gradual të narrativës dhe qëndrimeve ndërkombëtare ndaj Serbisë, ndërsa, sipas tij, politika shqiptare nuk ka arritur të krijojë një qendër të fortë politike, ekonomike dhe diplomatike në rajon. Ai argumentoi se, ndërsa Serbia ka rikthyer peshën e saj në Ballkan, shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë kanë qenë të përçarë.

Sipas gazetarit, një nga gabimet ka qenë qasja ndaj Serbisë si partnere. Abilekaj tha se kjo politikë është ndjekur për vite me radhë dhe se Shqipëria ka kontribuar në forcimin e një narrative që e ka paraqitur Beogradin si faktor të rëndësishëm dhe partner të mundshëm për Perëndimin.

Sipas tij, kjo qasje ka ndihmuar në rritjen e ndikimit të Serbisë në Perëndim dhe në Ballkan. Ai e lidhi këtë edhe me situatën politike në Kosovë, e cila, sipas tij, përballet prej kohësh me krizë institucionale, ndërsa vendimi i Hagës e gjen atë në një moment të vështirë politik.

"Politikanët shqiptarë kanë ndikuar që narrativa serbe, qëndrimet, që influenca serbe të shtohet edhe në Perëndim, që Serbia të bëhet gjithmonë e më e rëndësishme për Ballkanin dhe një vend që në '99-ën ishte i rrënuar nga bombardimet, të ribëhet prapë qendra e Ballkanit, qendra ekonomike dhe diplomatike e Ballkanit. Nuk u bë për shkakun tonë, për shkak të paaftësisë tonë për ta marrë këtë rol, për paaftësinë tonë për t'u bërë një qendër ekonomike e fortë, për paaftësinë tonë për t'u bërë një qendër politike dhe diplomatike e fortë. Dhe në qoftë se ne do vazhdojmë të jemi kështu, sigurisht që Serbia do vazhdojë të përparojë në axhendën e vet. Ne këtë e kemi ndihmuar duke thënë që Serbia mund të jetë partner. Është e njëjta deklaratë që ka bërë Nano, Rama pastaj, në '97-ën në Kretë me Millosheviçin, që tha: 'Ky që bëri luftën, do bëjë dhe paqen'. Dhe mendoj që kjo qasje e Ramës, e mazhorancës, por edhe e të gjithë shqiptarëve, ka ndikuar në këtë proces. Sot ky vendim na gjeti të gjithëve në faj. Na kapi në faj të gjithë dhe sot jo vetëm Kurti, sepse u kap në faj, sepse ka dy vjet që e kalon Kosovën pa qeveri, por të gjithë jemi kapur në faj. Të gjithë themi: çfarë kemi bërë ne deri tani", tha ai.

LAJMI I FUNDIT

21:38 Haxhiu: UÇK-ja nuk mbrohet duke i shpallur kundërshtarët politikë "spiunë" e "tradhtarë"

21:34 Kundërofensiva ukrainase "shpartallon" forcat ruse

21:27 Prishtinë, protestë masive kundër vendimit të Speciales ndaj drejtuesve të UÇK-së (VIDEO)

21:20 "Flirtet e Ramës me Vuçiçin"? SHPËRNDAJE
ARTIKULLINsh-ministri Vengu i përgjigjet akuzave

20:58 Hamza takon liderët e partive tjera: Diskutua për bashkëpunim në këtë periudhë të rëndësishme

20:51 OpenAI raporton raste të reja të sjelljeve të paparashikuar të modeleve të AI

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË

Haxhiu: UÇK-ja nuk mbrohet duke i shpallur kundërshtarët politikë “spiunë” e “tradhtarë”

Ushtruesja e detyrës së presidentes dhe kryeparlamentarja e Kosovës Albulena Haxhiu ka bërë thirrje për shmangien e shënjestërimeve të kundërshtarëve politikë si dëshmitarë apo si...

21:38 | 17/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR

Prishtinë, protestë masive kundër vendimit të Speciales ndaj drejtuesve të UÇK-së (VIDEO)

Edhe mbrëmjen e së enjtes është zhvilluar një protestë Prishtinë, para godinës së Qeverisë, kundër vendimit të Speciales ndaj drejtuesve të UÇK-së. Një numër...

21:27 | 17/09/2026

KOSOVË

Hamza takon liderët e partive tjera: Diskutuan për bashkëpunim në këtë periudhë të rëndësishme

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka njoftuar se ka takuar ndaras tre liderët e partive parlamentare shqiptare, Albin Kurtin e Vetëvendosjes, Lumir...

20:58 | 17/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.